



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:066605  
Datë: 06.03.2024  
Numri i dokumentit: 05420171

C.nr.566/21

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtoren profesionale V.D. në çështjen juridike të paditësve Sh.F. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit dhe M.F. nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson av. V.O. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.H. për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 29,756,00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë **29.01.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve **Sh.F. dhe M.F. nga Prizreni** dhe **OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, rr.”2 Korriku” që në emër të kompensimit të dëmit të paguaj shumat si në vijim:

**Për paditësen Sh.F.**

*a). Dëmi jo material:*

- Për dhimbje fizike (trupore) për të gjitha format shumë prej ..... 3.500,00 €.
- Për frikë shumë prej: .....3.000,00 €.
- Për shëmtim shumë prej: ..... 1.500,00.€.
- Për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 10%, shumë prej.....3.000,00 €

*b). Dëm material:*

- Për ndihmë të personit të tretë ..... 350,00 €
- Për ushqim të përforcuar shumë prej ..... 250,00 €
- Për shpenzimet e mjekimit shumë prej: ..... .656,65 €

Gjithsej në emër të dëmit material dhe jo material obligohet e paditura ti paguaj paditëses shumë prej 12,256.65 € ( dymbëdhjetëmijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e pesë cent) € me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi

( 29.01.2024) deri në pagesën definitive të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

### **Për paditësen M.F.**

#### *a). Dëmi jo material:*

- Për dhimbje fizike (trupore) për të gjitha format e saj shumën prej ..... 4.000,00 €.
- Për frikë shumën prej: ..... 3.500,00 €.
- Për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 9.75%, shumën prej.....3.500,00€

#### *b). Dëm material:*

- Për ndihmë të personit të tretë..... 200,00 €
- Për ushqim të përforcuar shumën prej ..... 150,00 €
- Për shpenzimet e mjekimit shumën prej: ..... 6.150,00€

Gjithsej në emër të dëmit material dhe jo material obligohet e paditura ti paguaj paditëses shumën prej 17,500.00 € ( shtatëmbëdhjetë e pesëqind euro ) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (29.01.2024) deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

**II.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar nga paditësit përtej shumave të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material e që kanë të bëjnë me rehabilitimin fizikoterapeutik klimatik, shpenzimet për veshmbathje dhe shpenzimet e mjekimit **refuzohen si të pabazuara.**

**III. OBLIGOHET** e paditura KS “Eurosig”, me seli në Prishtinë që në emër të shpenzimeve procedurale t’i paguajë paditësve shumën prej 1,801.00 € ( një mijë e tetëqind e një euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbarimit ligjor.

## **A r s y e t i m**

Paditësja Sh.F. dhe paditësja M.F. përmes të autorizuarit të tyre av. V.O. nga Prizreni kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 14.07.2023, për shkak të kompensimit të dëmit, përmes së cilës ka theksuar se me datë 25.12.2020 rreth orës 20:20 minuta, në Prizren në rr.”.....”, ka ndodhur aksident trafiku ashtu që deri të aksidenti ka ndodhur deri sa vozitësi Y.K. i cili ishte duke e drejtuar automjetin e markës VW Golf 1J, me targa ..... ishte duke lëvizur në shiritin e djathtë të rrugës dy shiritore, një kahore, me të arritur përballë “OSCE”, si pasojë e vozitjes së pakujdesshme dhe mospërshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes me pjesën frontale të automjetit i godet këmbësorët M.F., Sh.F. dhe R.A. të cilat në atë moment ishin duke kaluar rrugën nga krahu i majtë i lëvizjes së automjetit.

I autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe pas administrimit të provave materiale dhe ekspertizës së komunikacionit punuar nga eksperti Bajram Latifi, ekspertizës mjekësore punuar nga Dr. M.H. ortoped- traumatolog i cili ka dhënë mendimin e tij lidhur me natyrën dhe karakterin e lëndimeve trupore të paditësve si dhe Dr.V.B.R. e cila në cilësinë e ekspertes mjekësore të psikiatrisë ka dhënë mendimin e saj lidhur me intensitetin e frikës se përjetuar nga paditësit në aksidentin e datës 25.12.2020 ku është vërtetuar pa mëdyshje se e paditura ka përgjegjësi të plotë për kompensimin e dëmit material dhe jo material për lëndimet e paditësve që janë karakterizuar si lëndime të rënda trupore me pasojë për jetën, prandaj ka kërkuar që paditësve t'i kompensohen shumat si në precizimin e kërkesëpadisë dhe atë: për paditësen Sh.F. për dëmin material dhe jo material në shumë të përgjithshme prej 30.250,00€ dhe për paditësen M.F. shumën e përgjithshme prej 29.050,00€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, gjithashtu i njëjti ka kërkuar dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe atë për përpilimin e padisë për dy paditësit për vlerë të kontestit mbi 10.000 €, në shumë prej 416 €, për përfaqësimin në një seancë gjyqësore në shumë prej 405.6 €, për 6 seanca në shumë prej 2.496,00€, shpenzimet për pagesën e ekspertizave në shumë prej 600€, taksën gjyqësore në shumë prej 31€, të gjitha në shumë prej 3.543,00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

I autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimeve të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se mbetemi në tërësi si në përgjigje në padi, ku kërkesëpadinë e paditësve e kontestojmë pjesërisht për nga baza juridike për faktin se përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti kanë edhe paditësit, për arsye se të njëjtat kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësor, gjegjësisht pa kujdes të shtuar, po ashtu i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë pjesërisht si të bazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: leximin e ekspertizës së ekspertit të komunikacionit e përpiluar nga eksperti B.L. e datës 11.05.2023, leximin e ekspertizës ortopedike dhe psikiatrike të Dr. M.H. ortoped dhe Dr. V.B.R. psikiatër e datës 12.06.2023, leximin e raportit të aksidentit 2020- GR-0714 i datës 25.12.2020, leximin e dokumentacionit mjekësor, leximin e fletëdaljes me nr. të historisë 14085/8, raporteve specialiste të ortopedisë, fletë udhëzimet të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të gjithë kuponët fiskal dhe dëftesë pagesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje të çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e bazuar** dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase ka konstatuar gjendjen faktike si më poshtë.

Nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga eksperti B.L. e datës 11.05.2023 dhe dëgjimin e tij në seancë, gjykata ka konstatuar se aksidenti ka ndodhur me datë 25.12.2020, ku deri tek ky aksident ka ardhur përderisa shoferi i automjetit VW Golf, i cili po lëvizte nga Suhareka në drejtim të Prizrenit, me të arritur përballë objektit të OSCE- së, në hyrje të Prizrenit, si pasojë e vozitjes së pakujdesshme dhe mospërshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes me pjesën e përparme të automjetit të tij i godet tre këmbësoret, të cilat në momentin e aksidentit ishin duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë (shikuar sipas drejtimit të lëvizjes së automjetit) duke shkaktuar aksident komunikacioni. Deri te kontakti në mes automjetit dhe këmbësoreve vjen në shiritin e djathtë të rrugës (një kakshe me dy shirita të komunikacionit

për drejtim të lëvizjes). Ndërsa goditja është shkaktuar me pjesën e përparme (frontale) të automjetit në anën e djathtë të këmbësorëve të cilat në ato momente po e kalonin rrugën nga ana e majtë në të djathtë në “Vendkalimin e shënuar për këmbësorë”. Sipas kësaj ekspertize gjykata ka konstatuar se deri tek aksidenti ka ardhur si shkak i lëshimeve kryesore të shoferit të automjetit VW Golf, me tabela ..... dhe atë për shkak të shpejtësisë së lëvizjes kushteve të krijuara në rrugë dhe goditjes së këmbësorëve në vendkalimin për këmbësorë.

Nga ekspertiza ortopedike dhe psikiatrike e datës 12.06.2023, të punuar nga Dr. M.H. ortoped dhe Dr. V.B.R. Psikiatër, dhe dëgjimi i tyre në seancë, gjykata ka konstatuar se paditësja **Sh.F.** ka pësuar lëndime të rënda trupore. Këto lëndime paditëses i kanë shkaktuar **dhimbje fizike: a) Me intensitet posaçërisht të rëndë** – në kohëzgjatje prej 60 minuta, koha e kaluar nga aksidenti deri e deri në mjekim dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjes, **b) me intensitetit të lartë** - 3 ditë kohë pas kohë gjer në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh thyerjen e kërcirit të djathtë, **c) me intensitet të mesëm**- 50 ditë, kohë pas kohë gjer në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërlidhen me kohën e nevojshme për konsolidimin e thyerjeve, lidhjen dhe pastrimin e plagës operatore. Heqjen e penjëve, ndërrimin e imobilizimit, kontrollat sistematike dhe procedurat diagnostike, **d) me intensitet të ulët**- kronike vazhdon të ketë posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se paditësja **Sh.F.** ka përjetuar: **Frikë primare** - që ka zgjatur disa sekonda, e shfaqur prej momentit të goditjes së të dëmtuarës, në cilësi të këmbësorës nga ana e veturës, zhvendosje fizike të saj e deri te rënia përfundimtare në tokë, kur edhe ka përfunduar rreziku i drejtpërdrejtë për jetën e saj. Kjo frikë quhet frikë nga vdekja. **Frikë sekondare të intensitetit të lartë** – ka zgjatur 3 ditë, si gjendje stresi pas traumës, e shfaqur me shqetësim, ankth, reagime emocionale, parehati dhe frikë nga invaliditeti i mundshëm, bazuar në natyrën e lëndimeve, në mënyrën se si ka ndodhur aksidenti dhe moshën e të dëmtuarës. I është dhënë ndihma e parë mjekësorë, janë realizuar ekzaminimet e nevojshme diagnostike dhe frika primare është zbehur dhe ka kaluar në: **Frikë sekondare të intensitetit të mesëm:** e cila ka zgjatur 10 javë, duke u përballuar me pasojat shëndetësore të krijuara nga ky aksident, përfshirë qëndrimin në kushte spitalore, konsultat dhe tretmanët e shumta mjekësore, intervenimin kirurgjikal, mbajtjen e imobilizimit- gipsit të përcjella me porosi të detyruar, toaleta dhe fashimi i rregullt i plagës, përjetimin e herë pas hershëm të dhimbjeve trupore, pamundësi për të realizuar aktivitetet e përditshme jetësore në mënyrë të pavarur, me shqetësim dhe brengosje për ecurinë dhe suksesin e trajtimit dhe shërimit. Për shkak të problemeve me gjumë, me disponim, ankth, iritabilitet, me rikujtim të ngjarjes traumatike, e ka kërkuar ndihmën e mjekut psikiatër, i cili i ka përshkruar edhe terapinë adekuate. **Frikë sekondare të intensitetit të ulët- zgjatë ende**, herë pas here, sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion si dhe në situata të ngjashme me atë të aksidentit, duke bërë të ndiej shqetësimi dhe pasiguri. **Shëmtim trupor në shkallë të mesme** - për shkak të vrazës jo të rregullt si pasojë e plagës operatore në kërcirin e djathtë në formë kelloidi me gjatësi 20 cm dhe gjerësi 1.5 deri 4 cm e dukshme kohë pas kohe sidomos në periudhat e ngrohta të motit kur paditësja ekspozohet me veshje të shkurta, më gjerësisht të përshkruara si në ekspertizë. **Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor është i shprehur në shkallë 10%** që është si pasojë e kufizimit të lëvizjeve në shkallë të mesmetë njëjës së zogut të këmbës së djathtë. **Ndihma dhe kujdesi i huaj** - 50 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmën joprofesionale nga personat e tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike të përshkruara më gjerësisht në ekspertizë. **Ushqimi i përforcuar** – 50 ditë i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatik. **Rehabilitimi fiziatrik** - 25 ditë i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyje të zogut të këmbës së djathtë, gjurit të djathtë, boshtit kurrizor si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuara si pasojë e

shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit si pasojë e mbajtjes së imobilizimit me gips.

Nga ekspertiza ortopedike dhe psikiatrike e datës 12.06.2023, të punuar nga Dr. M.H. ortoped dhe Dr. V.B.R. Psikiatër, dhe dëgjimi i tyre në seancë, gjykata ka konstatuar se paditësja **M.F.** ka pësuar lëndime të rënda trupore, këto lëndime paditëses i kanë shkaktuar **dhimbje fizike - a) me intensitet posaqërisht të rëndë - 30 minuta**, koha e kaluar nga aksidenti deri te transporti, shtrirja pjesëve të lënduar, procedurat diagnostifikuese dhe invazive etj, deri në mjekim dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjes. **b) me intensitet të lartë 2 ditë** - kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e shumta trupore, të krahut dhe gjunjëve, **c) me intensitet të mesëm 8 javë**- kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërlihen me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve të ligamentit dhe menisqeve, ndërrimin e imobilizimit, kontrollat sistematike dhe procedurat diagnostike, **d) me intensitet të ulët**- vazhdon të ketë posaqërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se paditësja **M.F.** ka përjetuar: **Frikë primare** - që ka zgjatur disa sekonda, në momentin e perceptimit të rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën, kur në cilësinë e këmbësore është goditur nga automjeti, fizikisht është zhvendosur dhe ka rënë në tok. E njëjta është frikësuar për përfundim fatal - vdekje. **Frikë sekondare të intensitetit të lartë** - ka zgjatur 2 ditë, me simptoma të reaksionit akut në stres, e shfaqur në shqetësim, ankth, reagime emocionale, parehati dhe frikë, më gjerësisht të përshkruara si në ekspertizë. **Frikë të intensitetit të mesëm:** e cila ka zgjatur 8 javë, me angazhim të vazhdueshëm rreth gjendjes shëndetësore të krijuar në mënyrë të papritur, përfshi konsultat dhe tretmanët e shumta mjekësore, mbajtjen e imobilizimit- splintit të përcjellore me pozitë të detyruar, më gjerësisht të përshkruara si në ekspertizë. **Frika sekondare e intensitetit të ulur- zgjatë ende**, herë pas here, sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion si dhe në situata të ngjashme me atë të aksidentit, duke e bërë të ndiej shqetësim dhe pasiguri ndërsa **shëmtim trupor nuk ka. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm mjekësor është shprehur në shkallën 9.75%** që është pasojë e kufizimit të lëvizjeve (kontrakturës) në shkallë të lehtë të nyjës së krahut të djathtë pas lëndimit të strukturave kockore-ligamentozre (5%). **Ndihma dhe kujdesi i huaj** - për 30 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihme jo profesionale nga personat e tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike siç janë: veshmbathja, ushqimi, personale etj të përshkuara si në ekspertizë. **Ushqim i përforcuar** për 30 ditë, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatik. **Rehabilitimi fiziatrik-** për 30 ditë, i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyje të krahut të djathtë dhe boshtit kurrizor si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuara si pasojë e shtangimit të zhvilluar më nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit si dhe mbajtjes së imobilizimit me splint.

Nga leximi i raportit të aksidentit 2020-GR-0714 i datës 25.12.2020 gjykata ka vërtetuar faktin se me datë se me datë 25.12.2020, rreth orës 20:20 minuta, deri të ky aksident ka ardhur kur vozitësi i automjetit VW Golf, me targa te regjistrimit ..... i cili ishte duke lëvizur nga drejtimi i Suharekës në drejtim të Prizrenit me të arrit përballë "OSCE" si pasojë e vozitjes se pakujdesshme dhe mos përshtatshmërisë së shpejtësisë së lëvizjes me pjesën frontale të automjetit i godet tre këmbësore, të cilat në atë moment ishin duke kaluar rrugën nga krahu i majtë i lëvizjes së automjetit.

Nga leximi i fletëdaljes me nr. të historisë 14085/8, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Shefitka Fejza është pranuar në spital për shkak të thyerjes së pjesës së poshtme të

crurisit të djathtë të fituara në aksident trafiku. Pas pranimit ekzaminohet klinikisht me roentgen dhe elaborator. Pastaj ka pasur ndërhyrje kirurgjike dhe është trajtuar është lëshuar në shtëpi në gjendje të mirë duke vazhduar kontrollat e rregullta.

Nga leximi i dokumentacionit mjekësor, raporteve specialistike të ortopedisë, fletë udhëzimet të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të gjithë kuponët fiskal dhe dëftesë pagesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Sh.F. dhe M.F. kanë kërkuar ndihmë në Spitalin Rajonal të Prizrenit, si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e datës 25.12.2020, me ç ‘rast nga ana e mjekeve janë përshkruar lëndimet të cilat i ka marrë në aksident, gjithashtu kanë kryer vizita kontrole tjera të specializuara, nga provat e lartëcekura gjykata ka vërtetuar faktin se për kontrollat, incizimet e kryera sipas raporteve të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të njëjtit për shërbimet e kryera kanë paguar dhe shumat sipas faturave të cekura të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Pas administrimit, vlerësimit dhe analizimit të provave të cekura sikurse më lartë gjykata ka konstatuar gjendjen faktike sikurse në vijim dhe ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar nga arsyet e cekura si më poshtë.

Nga provat e administruara fillimisht gjykata ka konstatuar se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit këtu paditësve, në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (Ligjit nr.04/L-018), e lidhur me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), pasi që automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ishte i siguruar tek e paditura, fakti i cili është vërtetuar nga shkresat e lëndës dhe pala e paditur nuk e ka kundërshtuar.

Me rastin e vendosjes gjykata në rastin konkret ka marr për bazë rrethanat e rastit konkret, e posaçërisht raportin e ekspertizës të komunikacionit e përpiluar nga eksperti B.L. e datës 11.05.2023, ekspertizën ortopedike dhe psikiatrike e datës 12.06.2023, të punuar nga Dr. M. H. ortoped dhe Dr. V.B.R. Psikiatër, nga të cilat prova gjykata konstatoi se paditësja Sh.F. si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime të rënda trupore, ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, të mesëm si dhe të ulët, e po ashtu frikë primare dhe sekondare të intensitetit të lartë dhe të ultë, shëmtim trupor të shkallës së mesme, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 10 % dhe ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj, ushqim të përforcuar dhe shërim klimeterik. Paditësja M.F. si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore, ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, të mesëm dhe të ulët, e po ashtu frikë primare dhe sekondare të intensitetit të lartë dhe të ulët dhe ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj, ushqim të përforcuar dhe shërim klimeterik.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili zbatohet në këtë çështje juridike rregullon kompensimin e dëmit (material dhe jo material), kështu që neni 159 par.1 i këtij ligji përcakton **“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”**, par.2. përcakton: **“Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pasuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajësisë së tyre”**, par.3 përcakton **“Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjë anë, zotëruesit përgjigjen në pjesë të barabarta, në qoftë se shkaqet e drejtësisë nuk kërkojnë gjë tjetër”**, ndërsa par. 4 përcakton: **“Për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjeteve përgjigjen solidarisht”**. Neni 169 i LMD-së rregullon shpërblimin e dëmit material, respektivisht rivendosjen e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimin në të holla. Neni 174 i LMD-së përcakton se: **“Gjykata duke marrë parasysh**

***edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”.***

Ndërsa neni 179 i LMD-së, përcakton shpërblimin e dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, ndërsa në nenin 183 par.1 i këtij ligji përcakton: ***“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtëror, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, si dhe frikës etj, gjykata do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material .....”***, ndërsa par.2 përcakton: ***“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata merr parasysh rëndësinë e shkëlqes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërbeu ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj...”***.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për kompensimin e dëmit jo material dhe material duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së lidhur me nenin 136 par.1. të LMD-së, i cili përcakton se: ***“Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”***, e lidhur me nenet 159, 169, 174, 179 dhe 183 të LMD-së.

Lidhur me kërkesat e aprovuara në shumatat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet respektivisht format e tyre dhe frikën e pësuar nga paditësit Sh.F. dhe M.F. si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Ekspertët përkatës kanë vlerësuar se lëndimet e paditëseve janë lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të rënda trupore me pasoja më të gjata në shëndetin e tyre. Andaj edhe lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarve paditësve satisfaksion që të jenë në gjendje t'i kompensojë të mirat materiale dhe jo materiale nga të cilat janë privuar, e kjo duke pas parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilave gjykata ia fali besimin e plotë ngase janë përpiluar në mënyrë profesionale dhe është në harmoni me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me rastin e vendosjes si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi gjykata ka konstatuar se drejtuesi i automjetit A (VW), me tabela 04-211-FO të cilin e drejtonte Ylber Kalanderi, në këtë rast i siguruari i të paditurës është shkaktar i aksidentit bazuar në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit i cili ka konstatuar se deri të ky aksident ka ardhur si shkak i lëshimeve kryesore të shoferit për shkak të mospërshtatjes të shpejtësisë së lëvizjes kushteve të krijuara në rrugë, duke i goditur këmbësoret në vendkalim, të cilës provë gjykata ia fali besimin për shkak se e njëjta është e bazuar dhe profesionale.

Me rastin e caktimit të shpërblimit në të holla tek paditësit për të gjitha format të cilat janë vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata është bazuar në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr.41/2023 dt.27.02.2023 i cili hollësisht përcakton kriteret me rastin e përcaktimit të shumave orientuese, ndërsa në rastin konkret gjykata ka përcaktuar shumata të ndryshme për paditësit konkretisht për paditësen M.F. ka caktuar shumata pak më larta shpërbluese ngase e njëjta me e re në moshë.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi ngase shumatat e kërkuara nga paditësit mbi shumatat e aprovuara nuk janë të bazuara respektivisht sipas vlerësimit të

gjykatës janë të larta. Ndërsa lidhur me kërkesën e paditësve për kompensimin e shpenzimeve për veshmbathje dhe shërim klimaterik gjykata i refuzoi si të pabazuara ngase paditëset nuk kanë prezantuar kurrfarë prova materiale të cilat do ti vërtetonin pretendimet e tyre duke u bazuar në nenin 7 të LPK-së. Gjithashtu lidhur me shpenzimet e mjekimit për paditëset gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi shumë prej 656.56 € (për paditësen Sh.F.) e cila shumë është argumentuar me prova materiale, ndërsa shumë prej 6,150.00 € (për paditësen M.F.) për shkak se kaq ishte shuma e kërkuar përkundër faktin se provat materiale kapnin shumë më të lartë.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 378 dhe 382 të LMD-së dhe në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse, ku gjykata ka pranuar si moment të fillimit të llogaritjes së kamatës datën e marrjes së aktgjykimit (29.01.2024) ngase kështu ka qenë kërkesa e paditësve duke llogaritur kamatën prej 8 % në vit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi konform nenit 452 par.1 të LPK-së, e në të cilat janë përfshirë 156 € për përpilimin e padisë, për përfaqësim në 5 seanca gjyqësore 1.014.00 €, (5 x 202,80€), shumë prej 600 € për ekspertiza psikiatrike dhe ortopedike si dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 31 €, gjithsej në shumë prej 1.801,00€.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por konstatoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike – kontestimore.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.566/21, datë 29.01.2024**

**B. Profesionale,**

**Gjyqtari**

**Valmira Dakaj**

**Shaban Shala**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.